



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivety	10.03.2022	2 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHICK	1271/2022		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.700/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Jeton Koca anëtar si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.2962/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 18/01/2022 ka shqyrtuar ankesën me numër, A.nr.700/2019 të datës 07.11.2019 të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi fshati " " në çështjen juridike "Kontestim Konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10/03/2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.700/2019 e datës 07.11.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi njoftimi Nr.02-34674 i datës 01.11.2019 lidhur me rezultatin përfundimtar të procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa" i Komunës së Kamenicës.

A r s y e t i m

Komuna e Kamenicës pas marrjes së autorizimit më datë 21.08.2019 nga Ministria e Administratës Publike me datën 26.08.2019 ka shpallur konkursin me numër të protokollit 26333, datë 26/08/2019, për pozitën "Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa" në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, dhe i njëjti është i ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë). Komuna e Kamenicës pas përfundimit të procedurave të rekrutimit, përmes njoftimit Nr.02-34674 të datës 01.11.2019 ka publikuar

Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 18.01.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.2962/2019, përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 07.11.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr.2962/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative të datës 18/01/2022, të protokolluar në këshill me numër 707/2022 datë 14.02.2022; Ankesën me numër të protokollit 5263/2019 të datës 07.11.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Konkursin me numër të protokollit 26333 të datës 26.08.2019; Njoftimin me numër të protokollit 02/34674 të datës 01.11.2019 për kandidatin e suksesshëm; Vendimin me numër të protokollit 02/8/06 të datës 11.03.2015 për klasifikimin e vendeve të punës në komunë të Kamenicës; Akt emërimit me numër të protokollit 1492 të datës 1/3/2013 të ankuesit; regjistër i Pozitave të punës sipas MAP-it që lidhet me pozitën e ankuesit; Listën e pagave për muajin 01.04.2019 deri më 30.04.2019; Kërkesën për transfer drejtuar kryetarit të komunës me numër të protokollit 23987 të datës 09.08.2019; Kërkesën për transfer drejtuar kryetarit të komunës me numër të protokollit 2862 të datës 01.02.2019,Emalin e datës 30.08.2019 drejtuar MAP-it në lidhje me shpalljen e konkursit; Konkursin me numër 345/2018 të datës 08.06.2018 të shpallur nga komuna e Ferizajit; Konkursin me numër 01-111-29941 të datës 01.03.2019 të shpallur në komunën e Prizrenit; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 12.12.2017 për ankuesin; Formularin për vlerësimin rezultateve ne pune të datës 28.12.2018 për ankuesin; Ankesën drejtuar komisionit për ankesa me numër të protokollit 02-27058 të datës 02.09.2019; Përgjigjen në kërkesë me numër të protokollit 05-30346 të datës 01.10.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5334/2019 të datës 13.11.2019; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 5406/2019 të datës 18.11.2019; Përgjigje në ankesë me numër të protokollit 966/2022 të datës 23.02.2022 ;Emailin e datës 23.02.2022; Autorizimin e datës 21.08.2019 të Ministrisë së Administratës Publike; Formulari për kërkesën apo ankesë të datës 05.09.2019; Kërkesa me numër të protokollit 27668 të datës 05.09.2019 të kandidatës A.T; Diplomën e datës 18.03.2011 të kandidatës A.M; Dokumentin e identifikimit të kandidatës A.T; ID kartelën me numër 2016/2017 të universitetit të kandidatës A.T; Vërtetimin me numër 22/2017 të datës 12.05.2017; Pasqyra e llogarisë për periudhën kohore 01.08.2002-26.08.2019;kontrata e punës për kandidaten e pranuar,që konfirmon punësimin në kompaninë si në formularin e Trustit duke filluar nga data 01/03/2017,pa datë të lidhjes së kontratës ;Certifikatën e datës 10.01.2010; Certifikatën e datës 16.11.2007; Certifikatën e datës 04.09.2019 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjiilan lidhur me zhvillimin e procedurave penale dhe personave të dënuar nga kjo Gjykate; Formulari për kërkesë apo ankesë të datës 06.09.2019; Dokumenti i identifikimit te ankuesit Vërtetimin me numër te protokollit 02-27855 të datës 06.09.2019; Diplomën e datës 28.12.2000 te ankuesit; Certifikatën e datës 06.09.2019 të lëshuar nga Gjykata Themelore dega Kamenicë; Diplomën universitare e datës 18.06.2016 te ankuesit Certifikatën e datës 24.09.2014; Vërtetimin me numër 874 të datës 21.10.2005; Certifikatën e datës 29-28.05.2000; Certifikatën e datës 28.07.2000; Certifikatën lidhur me përfundimin e suksesshëm të kursit të kompjuterëve për periudhën kohore 10.09.2001 deri me datën 09.12.2001; Certifikatën e datës 30.01.2002; Vërtetimin me numër 09/RM të datës

10.07.2001; Kërkesën për fillimin e rekrutimit të datës 09.03.2019; Njoftimin me numër 02/35983 të datës 15.11.2019; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të datës 26.08.2019; Renditja përfundimtare e kandidatëve të datës 04.10.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa: Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 14.10.2019; Rekomandimi me numër 34674 të datës 01.11.2019 i KPSHC- i Komunës së Kamenicës; Njoftimin me numër të protokollit 34674 të datës 01.11.2019; Testi me shkrim i datës 03.10.2019 i kandidatës A.T; Testi me shkrim i datës 03.10.2019 i kandidatit Vendimi me numër 27365 i datës 03.09.2019 për plotësim dhe ndryshim të konkursit sh.02/26333 të datës 26.08.2019; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin A.T; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin Bujar Kastrati; Ndryshimi dhe Plotësimi i aktit të emërimit me numër 02-33565 i datës 02.10.2014 për ankuesit Emalin e datës 11.02.2021; Njoftimin me numër të protokollit 5619/2019 të datës 27.11.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji ka shqyrtuar pretendimin ankimor sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative me rastin e nxjerrjes së aktit administrativë respektivisht njoftimit Nr.02-34674 i datës 01.11.2019 lidhur me rezultatin përfundimtar të procedurës së rekrutimit për pozitën "*Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa*" i Komunës së Kamenicës, se i njëjti është nxjerrë me shkelje të dispozitave të LPA-së dhe atë nënitet 86 paragrafi 1 dhe 3, akti administrativë nuk përmban elementet e domosdoshme që duhet të ketë një akt administrativë sipas LPA-së dhe se nuk përmban elemente të informacioneve të nevojshme konform nenit 84 të LPA-së, kolegji duke ju referuar këtij pretendimi konstaton se përveç që nuk është specifikuar saktë se cilit Ligj të Procedurës së Përgjithshme Administrative(LPPA-së) i referohet ankuesi nga se nëse i referohemi nenit 84 të LPA-së, të apostrofuar në këtë pretendim vërehet se neni 84 i LPPA-së që është në fuqi rregullon çështjen e bashkimit të procedurës administrative në një procedurë e jo çështjes së cilës i referohet ankuesi sipas kësaj dispozite, ndërsa kolegji konstaton se pas njoftimit Nr.02-34674 i datës 01.11.2019 lidhur me rezultatin përfundimtar të procedurës së rekrutimit për pozitën "*Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa*" i Komunës së Kamenicës, nxjerrët njoftimi 02-35983 i datës 15/11/2019 nga Menaxheri i Personelit të Komunës së Kamenicës përmes së cilit njoftohet hollësisht kryetari i Komunës për rrjedhën e konkursit dhe kandidatin e rekomanduar për këtë pozitë sipas këtij konkursi duke kërkuar nga i njëjti që të nxjerrë vendim për pranim në punë të kandidatës së rekomanduar nga komisioni, andaj kolegji vlerëson se njoftimi që është objekt i kësaj ankesë është pasuar nga njoftimi 02-35983 i datës 15/11/2019, ndërsa ndaj të njëjtit nga shkresat e lëndës nuk kemi hasur se ka pasur ndonjë ankesë, andaj kolegji konstaton se pretendimi është i pabazuar në këtë aspekt nga fakti se nuk është i specifikuar konform legjislacionit në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit i cili pretendon se organi i punësimit ,Komuna e Kamenicës, konkursin për pozitën "*Zyrtar i lartë*

për Buxhet dhe Financa" e ka zhvilluar në kundërshtim me Ligjin për Zyrtares Publik konkretisht me nenin 38 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 33 paragrafi 2 pika 2.2. dhe 2.3,që ka të bëjë me lëvizjen brenda kategorisë dhe ngritje në detyrë, Kolegji pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se konkursi për pozitën "Zyrtares i lartë për Buxhet dhe Financa" i shpallur me datën 26.08.2019 është shpallur bazuar në nenin 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil ,që nënkupton se në këtë kohë të shpalljes së këtij konkursi nuk ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtareset Publik së cilit i referohet ankuesi në lidhje me këtë pretendim, kolegji duke u bazuar në pretendimin e ankuesit përveç që nuk i referohet ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e shpalljes së konkursit, Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, poashtu i njëjti ligj nuk e ka parapare edhe lëvizjen brenda kategorisë, andaj mbi këtë bazë konstaton se pretendimi i ankuesit është i pa bazuar.

Kolegji Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se kandidatja e përzgjedhur në këtë pozitë sipas këtij konkursi nuk ka plotësuar kriterin e përvojës profesionale prej 3 vite, dhe ndërlidhur me këtë pretendim kolegji ka shqyrtuar kriteret e konkursit të përcaktuar në konkursin e datës 26.08.2019, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se për pozitën e punës " Zyrtares i Lartë për Buxhet dhe Financa" në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, në Komunën e Kamenicës, kriteret e konkursit kanë qenë: **"Diplomë universitare, fakulteti Ekonomik, Financa, Biznes, apo të ngjashme, tri (3) vite përvojë pune profesionale"**. Në bazë të shkresave të lëndës gjegjësisht Diplomën me Nr.1787 të datës 25/05/2011 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, konstatohet se kandidatja e rekomanduar për këtë pozitë, A.T me datë 18.03.2011 ka përfunduar studimet themelore në Universitetin e Prishtinës, fakulteti ekonomik në drejtimin Menaxhment dhe Informatik duke marrë titullin Baçelor për Menaxhment dhe Informatikë, që nënkupton se ka plotësuar kriterin sa i përket përgatitjes profesionale. Sa i përket përvojës profesionale, në bazë të vërtetimit me Nr.22/2017 të datës 12.05.2017 të Drejtorisë për Financa dhe Buxhet në Komunën e Kamenicës vërtetohet se kandidatja e përzgjedhur ka përfunduar një (1) vit, punë-praktike në këtë drejtori, ndërsa në bazë të kontratës së punës me kompaninë "Galvakos" shpk nga Kamenica që gjendet në shkresat e lëndës konfirmohet punsimi në këtë kompani nga data 01/03/2017 deri sa është punësuar sipas këtij konkursi, ndërsa në bazë të llogarisë së Trustit për periudhën 01/08/2002-26/08/2019 kandidatja e përzgjedhur ka 29 muaj përvojë pune që i bie se gjithsej kandidatja e përzgjedhur ka tri (3) vite e (5) muaj përvojë pune të cilat dëshmojnë edhe në shkresa të lëndës dhe rrjedhimisht ka plotësuar kriterin e konkursit lidhur me kualifikimin dhe përvojën profesionale, ashtu që përzgjedhja në këtë pozitë është në harmoni me nenin 11 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil ku përcaktohet se :**"Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve"**, në këtë kuptim pretendimi i ankuesit është i pabazuar. Kolegji po ashtu duke iu referuar njoftimit Nr.02-34674 të datës 01.11.2019 të renditjes përfundimtare të kandidatëve respektivisht përzgjedhjes së kandidatit të suksesshëm, ka gjetur se kandidatja e përzgjedhur pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me 77.7 pikë ndërsa ankuesi është renditur i dyti me 75.3 pikë, andaj në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numrin më të madh të pikëve siç parashihej në nenin 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: **"Në Shërbimin Civil**

emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”, andaj pretendimi ankimor edhe mbi këtë bazë është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar edhe pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se me vendimin e datës 11.03.2015 me numër 806 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës është formuar komisioni për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbim Civil të kësaj komune i cili komision ankuesin e ka klasifikuar në vendimin e punës “Zyrtar i Larte për Buxhet dhe Financa”, dhe se Komuna e Kamenicës gabimisht ka hapur konkursin publik për pozitën “Zyrtar i Larte për Buxhet dhe Financa” sepse është dashur që të bëhet lëvizja paralele brenda kategorisë, në këtë rast kolegji vlerëson se ankuesi është dashur që pas vendimit të datës 11.03.2015 të parashtojë kërkesë/ankesë brenda afateve ligjore lidhur me realizimin e kërkesës për ndryshim të aktemrimit e në këtë kuptim pretendimi është jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh të paraparë me nenin 130 paragrafin 130.1 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, i cili përcaktonte se: **“130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda tridhjetë (30) ditësh”** ligj që ishte në fuqi në këtë periudhë, ndërsa po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuar nga ankuesi dhe në bazë të përgjigjes së institucionit nuk është vërtetuar me ndonjë shkresë se ndaj ankuesit Komuna e Kamenicës ka ndërmarr ndonjë veprim lidhur me ndryshim të përshkrimit të detyrave të punës së ankuesit sipas dokumentit që i referohet ankuesi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.700/2019, datë 10/03/2022

Ilire Mehmeti Shaqiri

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës, dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së